



Organizata Jo-qeveritare Emancipimi Civil Ma Ndryshe
EC MA NDRY SHE

KOMUNIKATË PËR MEDIA

Nxënësit informohen mbi të drejtat dhe shqetësimet e PNV-ve

EC Ma Ndryshe dhe OPDMK (Organizata e Personave me Distrofi Muskulare të Kosovës) kanë nisur serinë e ligjëratave në shkollat e mesme të Prizrenit, për të informuar nxënësit mbi të drejtat dhe shqetësimet e Personave me Nevoja të Veçanta, si dhe për t'i ftuar ata që të jenë pjesë e aktiviteteve të ardhshme në këtë drejtim.

Prezantimet para nxënësve realizohen nga vet Personat me Nevoja të Veçanta, me ç'rast zhvillohen edhe diskutime mbi qasjen dhe pjesëmarrjen, me përqendrim në nevojat e Personave me Nevoja të Veçanta.

Duke përdorur mjete dhe metoda kreative dhe përfshirëse, projekti "Prizreni, qytet pa pengesa", sjellë një qasje alternative për mobilizimin e komunitetit dhe avokimin e bazuar në të drejta për personat me nevoja të veçanta.

OJQ EC Ma Ndryshe dhe OPDMK në shkurt të këtij viti kanë filluar realizimin e projektit "Prizreni, qytet pa pengesa", i cili përkrahet nga USAID. Qëllimi i përgjithshëm i projektit përfshinë rritjen e pjesëmarrjes së Personave me Nevoja të Veçanta dhe të rinjve në projektimin e Prizrenit pa pengesa. Përfitues kryesorë të projektit do të jenë Personat me Nevoja të Veçanta dhe nxënësit e shkollave të mesme të qytetit të Prizrenit.

Me respekt,
Valon Xhabali, Koordinator i programit
OJQ EC Ma Ndryshe

Projekti "Prizreni, një qytet pa pengesa" përkrahet financiarisht nga USAID, mbikëqyret nga ATRC dhe implementohet nga EC Ma Ndryshe dhe OPDMK. Qëllimi i përgjithshëm i projektit përfshinë ngritjen e pjesëmarrjes së personave me nevoja të veçanta dhe të rinjve në projektimin e Prizrenit pa pengesa.